



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT

Nr. 618 prot.

Tiranë, më 17.03 2022

VENDIM

Nr.1, datë 07/03/2022

PËR

MIRATIMIN E LEJES “PËR PËRDORIM BURIMI UJOR”
ME QËLLIM NDËRTIMIN E STRUKTURAVE ANKORUESE,
PORTUALE NË DET, ME VENDNDODHJE: PORTI DETAR LIMION,
BASHKIA SARANDË, QARKU VLORË

Në mbështetje të shkronjës “b” të pikës 2, të nenit 41, të ligjit nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, i ndryshuar dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.550, datë 15.07.2020, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim për dhënien me koncension të përdorimit të burimit ujor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratit e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujrave të pëdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimarrjes, të formateve të lejes, të autorizimit, të kushteve të posaçme dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli Kombëtar i Ujit

V E N D O S I:

1. Miratimin e lejes, “Për përdorim burimi ujor”, me qëllim ndërtimin e strukturave ankoruese, portuale në det, me vendndodhje: Porti Detar Limion, Bashkia Sarandë, Qarku Vlorë, për subjektin “MARINA LIMION” sh.p.k.
2. Treguesit paraprakë janë si më poshtë:

Emri i burimit ujor: Gjiri i Limionit Sarandë

Vendndodhja e burimit ujor (KRGJSH).

X1 498928.74	Y1 4415573.22	Z1 4 m.m.n.d
X2 499236.74	Y2 4415321.22	Z2 13 m.m.n.d
X3 499158.34	Y3 4415035.62	Z3 0 m.m.n.d
X4 498900.74	Y4 4414951.62	Z4 0 m.m.n.d
X5 498659.94	Y5 4415114.02	Z5 5 m.m.n.d

X6 498657.14


Y6 4415380.02

Z6 17 m.m.n.d

Lloji i veprimtarisë që do të kryhet: Port turistik dhe shërbimesh, Marina Limion.

3. Gjatë fazës së ndërtimit dhe shfrytëzimit të kësaj strukture, të lejohet kalimi i qetë i mjeteve lundruese që do të përdorin pjesë të tjera të gjirit jashtë objektit të koncesionit, të cilat nuk pengojnë aktivitetin e Portit dhe të jetë në përputhje me legjislacionin dhe udhëzimet/rregulloret/urdhërat përkatës në fuqi.
4. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas njoftimit të përmbajtjes së vendimit subjektiv.



**AGJENCIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE UJORE
DREJTOR I PËRGJITHSHËM**

